



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë
Kundër Korrupsionit
Janar-Maj 2011



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



INSTITUTE FOR
Sustainable
Communities

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID-i përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile dhe implementuar nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e USAID ose ISC.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Hyrje	5
Qeveria e Kosovës	6
Kuvendi i Kosovës	7
Sistemi Gjyqësor	9
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	9
Prokuroria e Kosovës	10
Policia e Kosovës	12
Agjencia Kundër Korrupsion	13
Doganat e Kosovës	14
Falënderime	16
Rreth Lëvizjes FOL	16

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

AKR - Aleanca Kosovare e Re

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

ISC - Institute for Sustainable Communitities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KQZ - Komisioni Qendror Zgjedhor

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

MM - Memorandum Mirëkuptimi

MTPT - Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit

OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PK - Policia e Kosovës

PQ - Prokuroritë e Qarkut

PTK - Postë-Telekomi i Kosovës

RP - Raporti i Progresit

TI - Transparency International

USAID - United States Agency for International Development (Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar)

VV - Lëvizja Vetëvendosje!

Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Kosovës gjatë pesë muajve (janar-maj) ka miratuar gjithsej 80 vendime. Nga këto vendime vetëm njëri ka qenë në luftë kundër korrupsionit. Me këtë vendim qeveria ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar për punonjësit e saj. Në kuadër të këtyre vendimeve ka qenë edhe ai për themelimin e Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit dhe ai i Strategjisë Legjislative për vitin 2011. Në kuadër të kësaj strategjie do të hyjnë: projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, projekt-ligji për mbrojtjen e raportuesve (ëhistle bloëers laë), projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimin të Organizuar, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike;

Kuvendi i Kosovës gjatë pesë muajve ka mbajtur gjithsej 13 seanca plenare. Prej tyre 2 janë mbajtur në muajin shkurt, 7 në muajt mars-prill dhe 6 sosh në muajin maj. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi ka miratuar një sërë marrëveshesh ndërkombëtare, ka mbajtur një interpelancë për bisedimet Kosovë-Serbi, ka mbajtur tri debate parlamentare dhe ka miratuar disa raporte. Në kuadrin e tyre është edhe ai i Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2010;

Këshilli Gjyqësor i Kosovës gjatë tre mujorit të parë nuk është treguar produktiv në zgjidhjen e lëndëve anti-korrupsion. Në kuadër të kategorisë “shpërdorim me detyrën zyrtare ose autorizimit” kanë qenë 81 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 17 lëndë të pranuar në punë, 98 lëndë aktualisht në punë, vetëm 14 lëndë të zgjidhura dhe gjithsej 84 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Në kuadër të kategorisë “marrja e ryshfetit” kemi 21 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 2 të pranuar në punë, 23 lënë aktualisht në punë, 0 lëndë të zgjidhura dhe 23 kanë mbetur të pazgjidhura. Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi 9 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 0 lëndë të pranuar në punë, 9 lëndë aktualisht në punë, 0 lëndë të zgjidhura dhe 9 kanë mbetur të pazgjidhura;

Prokuroritë e Qarkut nga shqyrtimi i lëndëve dhe hetimeve të bëra kanë ngritur gjithsej 15 aktakuza: 4 aktakuza në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë; 8 në atë të Pejës, 1 në atë të Gjilanit, 1 në atë të Prizrenit dhe 1 tjetër në atë të Mitrovicës. Ndërkaq Prokuroritë Komunale kanë ngritur 16 akt-akuza dhe 40 propozim-aktakuza: 3 aktakuza dhe 19 propozim-aktakuza në Prokurorinë e Prishtinës; 2 aktakuza në atë të Pejës, 1 aktakuzë dhe 5 propozim-aktakuza në atë të Gjilanit; 2 aktakuza dhe 4 propozim-aktakuza në atë të Prizrenit; 7 aktakuza dhe 4 propozim-aktakuza në atë të Mitrovicës, 3 propozim-aktakuza në Prokurorinë e Gjakovës dhe 1 aktakuzë e 5 propozim-aktakuza në atë të Ferizajt;

Monitoruesi i Korrupsionit

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se Policia e Kosovës gjatë muajve janar-maj ka zhvilluar gjithsej 245 hetime: 120 raste në muajt janar-shkurt, 108 raste në muajt mars-prill dhe 17 raste në muajin maj. Prej këtyre hetimeve kanë përfunduar 36 zyrtarë të arrestuar: 16 në muajt janar-shkurt, 3 në muajt mars-prill dhe 17 në muajin maj. Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përlllogaritet të jetë 4,807,984.00: 2,603,591.00 € në muajt janar-shkurt, 141,455.00 € në muajt mars-prill dhe 2,062,938.00 € në muajin maj;

Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë e përqendruar tek procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, tek publikimi i Raportit Vjetor 2010 dhe te miratimi i tij në Kuvendin e Kosovës. Numri i zyrtarëve të lartë publik të cilët kanë pasur për obligim ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë 1830. Nga ky numër vetëm 1746 ose 95.40% e kanë përmbushur obligimin ligjor. Numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 84 zyrtarë apo 4.60%, ndërsa 26 zyrtarë të tjerë nuk e kanë plotësuar formularin në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet/kriteret e përcaktuara nga AKK-ja. Ndërkaq sipas Raportit Vjetor 2010 që ka publikuar AKK-ja rezulton se nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar në Agjenci, hetuesit e Agjencisë kanë gjetur elemente bazike për te filluar hetimet në gjithsej 139 raste: 27 raste ndaj gjykatave, 44 raste ndaj qeverisë, 22 raste ndaj nivelit komunal, 3 raste ndaj prokurorive dhe 47 sosh ndaj institucioneve tjera - kryesisht ndërmarrjet publike;

Doganat e Kosovës gjatë pesë muajve kanë shqiptuar gjithsej 19 masa disiplinore. Në kuadër të tyre 3 kanë qenë në muajin janar, 8 në muajin shkurt, 5 në muajin prill dhe 3 të tjera në muajin maj. Në kuadër të këtyre masave disiplinore 7 raste janë vërejtje me shkrim/gojë, 5 raste ndalim promovimi, 2 raste transfer në detyrë tjetër, 2 raste rekomandim për trajnim, 1 rast degradim nga pozita, 1 rast tjetër anulim performanse dhe 1 rast kompensim i pronës së dëmtuar të Doganave. Ndërkaq në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale janë paraqitur gjithsej 17 raste: 4 raste në muajin janar, 5 raste në muajin shkurt, 4 raste në muajin mars, 4 raste në muajin prill dhe 1 rast tjetër në muajin maj. Muaji shkurt pra ka pasur më shumti raste, ndërkaq muaji maj më së paku - me vetëm një rast. Në kuadër të Sektorit të Standardeve Profesionale kemi 3 raste të shqiptuara për sjellje jo-profesionale gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, 1 rast për mos-deklarim të pasurisë, 4 raste për humbje/dëmtim të pronës së Doganës dhe 1 rast për mos-paraqitje në punë.

Hyrje

Niveli i lartë i korrupsionit¹ dhe shtrirja e gjerë e tij në instancat më të larta dhe më të ulëta qeverisëse përbën rrezikun kryesor për proceset e shtet-ndërtimit², zhvillimin ekonomik³, transicionin demokratik⁴ dhe qeverisjen cilësore⁵. Ky konstatim pranohet gjerësisht nga segmente të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Të gjithë pajtohen se korrupsioni jo vetëm që është duke i dëmtuar interesat e qytetarëve të Kosovës, por edhe procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.⁶ Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar ka alarmuar edhe deputetët e Bundestagu-t gjerman. Disa nga ata kanë pohuar që “paratë e qytetarëve gjermanë po investohen në vila private të politikanëve kosovare”.⁷ Në këtë linjë janë edhe raportet e shumta prestigjioze ndërkombëtare. Ato kanë pasqyruar një shkallë të lartë të korrupsionit, krimit të organizuar dhe ekonomisë informale.

1 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës sanksionon 13 lloje të veprave korruptive: shpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit, përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrim në detyrë, përdorim i paautorizuar i pasurisë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, ushtrim i ndikimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, zbulim i fshehtësive zyrtare, falsifikim i dokumenteve zyrtare, arkëtim dhe pagesa e paligjshme, lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, përvetësim i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

2 Kjo tezë është rezultat i observimeve empirike, pasi që niveli i lartë i korrupsionit po e dëmton seriozisht legjitimitetin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar të Kosovës

3 Më shumë rreth efekteve negative dhe të dëmshme të Korrupsionit shih <http://www.oecd.org> dhe website-n dhe Raportet e Transparency International: <http://www.transparency.org>

4 James B. JACOBS: Korrupsioni dhe Demokracia, Kappa Phi Journal, Volumi 84, 2004, fq. 21

5 United States Agency for International Development (USAID) - Tw luftosh korrupsionin: <http://www.usaid.gov/our-work/democracy-and-governance/technical-areas/anti-corruption/>

6 Renzo DAVIDDI: Korrupsioni po e dëmton procesin e integritetit të Kosovës në BE, Koha Ditore, 11 qershor, 2010, fq. 6

7 Florian HAHN, Botuar në Koha Ditore: Deputetët gjermanë akuzojnë Qeverinë e Kosovës për krim dhe korrupsion, 11 qershor, 2010, fq. 4

Bazuar në të gjeturat e tyre Kosova renditet krahas shteteve më të korruptuara në botë dhe përkrah shteteve të dështuara. Derisa bartësit institucionalë kanë premtuar se do ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, opozita ka shprehur kritikën, akuzat dhe mosbesimin e saj. Në këtë kontekst, duke parë me shqetësim të madh këtë fenomen endemik, Lëvizja FOL, me përkrahje të USAID-it përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC - Instituti për Komunitete të Qëndrueshme, është duke e realizuar projektin e saj ‘Monitoruesi i Korrupsionit’ që nga Janari i vitit 2010. Përmes këtij projekti FOL mëton të nxjerrë në shesh (mos)punën e institucioneve karshi korrupsionit, duke ndikuar që kjo luftë të jetë në krye-agjendën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës”.⁸ FOL konsideron se lufta ndaj korrupsionit duhet të kalojë nga sfera e retorikës në atë të veprimeve konkrete, qasjes serioze dhe rezultateve të prekshme. Kjo është rruga e vetme që Kosova ta përmirësojë legjitimitetin e saj të brendshëm dhe ndërkombëtar. Ta etablojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të jetë e krahueshme me shtetet perëndimore dhe shoqëritë e lira.


KOHA është TANI.

8 Hasan PRETENI - Edicioni i Lajmeve (19:30), RTK, 6 qershor, 2010

Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës gjatë pesë muajve (janar-maj) ka miratuar gjithsej 80 (tetëdhjetë) vendime. Nga këto vendime vetëm një ka qenë në luftë kundër korrupsionit. Gjatë dy muajve të parë qeveria "Thaçi 2" ka miratuar gjithsej 3 vendime. Nga këto vendime asnjë nuk ka qenë në luftë kundër korrupsionit, krimin të organizuar apo ekonomisë informale. Në kuadër të këtyre vendimeve ka qenë edhe ai për rritjen e pagave për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues, shërbyesit civilë, oficerët doganorë dhe personelin e ATK-së, për sektorin e shëndetësisë, zjarrfikësit dhe minatorët.⁹ Kjo rritje nuk ka qenë në linjë me objektivat e përcaktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.¹⁰ Shkelja e kësaj marrëveshjeje ka qenë e befasishme jo vetëm për FMN-në, por edhe për edhe për Bankën Botërore dhe për Bashkimin Evropian.¹¹ Me këtë vendim qeveria ka vënë në rrezik humbjen e ndihmave financiare. Pjesa më e madhe e këtyre ndihmave do të vinin nga FMN-ja,

Banka Botërore dhe BE-ja.¹² Në këtë muaj është rimanduar për të dytën herë qeveria e Kosovës: me 65 vota pro, 1 kundër dhe pa abstenime.¹³ Në dy muaj tjerë (mars-prill) qeveria ka miratuar gjithsej 50 (pesëdhjetë) vendime. Nga këto vendime asnjë nuk ka qenë në luftë kundër korrupsionit, krimin të organizuar apo ekonomisë informale. Në kuadër të këtyre vendimeve ka qenë edhe ai për themelimin i Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit.¹⁴ Kjo



njësi do të funksionojë Brenda Policisë së Kosovës dhe do të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Prokurorinë e Shtetit. Përveç këtij vendimi është edhe ai i Strategjisë Legjislative për vitin 2011.¹⁵ Në kuadër të kësaj strategjie do të hyjnë: projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Deklarimin,

⁹ Për më shumë detaje shih vendimin e qeverisë, nr. 02/151, 6 janar, 2011

¹⁰ Komunikata e Fondit Monetar Ndërkombëtar: <http://www.imf.org/external/np/sec/pr/2011/pr1180.htm>, 15 mars, 2011

¹¹ Radio Evropa e Lirë: Intervistë me Drejtorin ekzekutiv i Institutit RIINVEST, Lumir, Abdixhiku - <http://www.evropaelire.org/content/article/2298506.html?s=1>, 5 shkurt, 2011

¹² Me gjerësisht shih <http://www.riinvestinstitute.org/index.php?giuha=al&action=meshume&cid=10&sid=38&id=143>, 5 shkurt, 2011

¹³ Me gjerësisht shih <http://www.koha.net/index.php?cid=1.7.50386>, 24 shkurt, 2010

¹⁴ Qeveria e Kosovës, Vendimi nr. 04/02, 2 mars, 2011

¹⁵ Po aty, nr. 02/05, 16 Mars, 2011, fq. 1

Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, ai për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, projekt-ligji për mbrojtjen e raportuesve (whistle blowers law), projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike.¹⁶ Ndryshimi i ligjeve ekzistuese dhe miratimi i projektligjeve të tjera përbëjnë hapin më të rëndësishëm për kompletimin e paketës anti-korrupsion, e cila më pastaj do t'i reduktojë ndjeshëm hapësirat ligjore që ekzistojnë në ligjet ekzistuese për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ndërkaq gjatë muajit maj janë miratua gjithsej 27 vendime, ku njëri prej tyre ka qenë në luftë kundër korrupsionit. Me këtë vendim qeveria ka përkrahur kërkesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulimin financiar për punonjësit e saj. Shuma që është përkrahur është 130,000.00 Euro sipas kategorive:

- 900.00 € për zëvendëskryeprokuroren;
- 800.00 € për 9 prokurorë special;
- 130.00 për 12 zyrtarë;
- 100.00 për 21 personel mbështetës¹⁷

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës gjatë pesë muajve ka mbajtur gjithsej 13 seanca plenare. Prej tyre 2 janë mbajtur në muajin shkurt, 7 në muajt mars-prill dhe 6 sosh në muajin maj. Në muajin shkurt Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 2 seanca plenare: njëra konstituive dhe tjetra e jashtëzakonshme. Derisa në seancën e parë është bërë betimi i deputetëve dhe është zgjedhur kryetari e nënkryetarët e Kuvendit, në seancën e dytë është zgjedhur Presidenti dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Deputetët e opozitës (LDK, Vetëvendosje! dhe AAK) e kanë braktisur seancën e dytë, ndërkaq partitë e tjera (PDK, Koalicioni për Kosovë të Re dhe partitë minoritare) kanë qëndruar në sallë. Procesi i zgjedhjes së presidentit është shoqëruar me parregullsi dhe debate të shumta. Pas dy raundeve, kur ai nuk mori as minimumin e votave - herën e parë 54 e të dytën 58 vota, nga 67 deputetë të pranishëm, pas një pauze, të cilësuar kundër-kushtetuese dhe në kundërshtim me Rregulloren e punës të Kuvendit¹⁸, në rundin e tretë mori 62 vota dhe është shpallë president i tretë i shtetit të Kosovës.¹⁹ Në këtë seancë është votuar edhe Qeveria e Kosovës me 65 vota pro, 1 kundër dhe pa abstenime.²⁰

16 Me gjerësisht shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Legjislative_2011-finale-e_miratuar_me_16_mars_2011.pdf

17 Me gjerësisht shih vendimin e Qeverisë, nr. 05/14, 4 maj, 2011, fq. 1

18 Ky konstatim është thënë nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, Seanca e Kuvendit, 22 shkurt, 2011
19 Më shumë rreth zgjedhjes së presidentit shih <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,22,50332>, 22 shkurt, 2011


20 Po aty

Kuvendi i Kosovës gjatë dy muajve (mars dhe prill) ka mbajtur gjithsej 7 seanca plenare. Prej tyre 4 (katër) janë mbajtur në muajin mars dhe 3 (tri) sosh në muajin prill. Në seancën e parë është miratuar vendimi i Qeverisë lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars 2011.²¹ Në seancën e

dytë është diskutuar për bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për Kosovën. Deputetët e opozitës (LDK, Vetëvendosje! dhe AAK-së) kanë shprehur kritikën e tyre për fillimin dhe mënyrën e zhvillimit të negociatave, ndërkaq shumica e deputetëve të

opozitës i kanë përkrahur këto bisedime.²² Në seancën e tretë është miratuar rezoluta që autorizon Qeverinë e Kosovës për bisedime me Serbinë. Në këtë seancë është aprovuar edhe formimi i komisioneve parlamentare: 4 komisione të përhershme dhe 9 sosh funksionale.²³ Ndërkaq në seancën e fundit për muajin mars janë miratuar projektligji për buxhetin e Kosovës dhe komisioni për regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare. Deputetët e opozitës e kanë kritikuar qeverinë Thaçi pse e ka inkorporuar privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës (PTK) brenda buxhetit. Përveç kësaj, opozitarët e kanë

kritikuar edhe për rritjen e pagave, duke e akuzuar kryeministrin Thaçi që e ka përdorur këtë vendim vetëm për efekte elektorale. Në seancën e parë të muajit prill është bërë zgjedhja e presidentes. Me 80 vota pro është zgjedhur Ahtifete Jahjaga, 10 vota ka marrë Suzan



Novbërdaliu dhe 10 vota të pavlefshme.²⁴ Në atë të dytën është diskutuar mbi nevojën e themelimit të një komisioni parlamentar mbi hetimin e veprimtarisë së SHIK-ut, dukë përfshirë bazën legale të funksionimit të saj, mjetet e financimit, mekanizmat, përgjegjësitë, etj. Në këtë seancë është aprovuar themelimi i Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Komisioni për amendamentimin e Ligjit përzgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës.²⁵ Po ashtu, gjatë kësaj seance është zgjedhur Governori i ri i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Gani Gërguri. Ky nga 99 vota ka marrë gjithsej 58 vota, 15 i ka marrë kundërkandidati i tij dhe 26 vota kanë qenë të

21 Ky vendim, ani pse me shumë kritika, është miratuar nga ana e të gjithë deputetëve në sallë – 114 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

22 Kuvendi i Kosovës, Transkripti i Seancës Plenare, 7 Mars 2011

23 Po aty, Transkripti i Seancës Plenare, 10 Mars, 2011

24 Po aty, Transkripti i Seancës Plenare, 7 Prill 2011

25 76 vota kanë qenë pro, 6 kundër dhe 4 abstenime


pavlefshme.²⁶ Në këtë seancë janë miratuar edhe një numër i madh raporteve, siç është ai i OSHP-së dhe KRPP-së. Ndërkaq në seancën e fundit të këtij muaji janë miratuar një sërë ligjesh tregtare dhe është miratuar një rezolutë për të shprehur qëndrimin afirmativ të Kosovës për integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Ndërkaq, në seancat plenare të muajit maj janë shqyrtuar një sërë projekt-ligjesh, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë në kuadër të sferës antikorrupsion. Gjatë këtij muaji Kuvendi ka miratuar një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare, ka mbajtur një interpelancë për bisedimet Kosovë-Serbi, ka mbajtur tre debate parlamentare dhe ka miratuar disa raporte. Në kuadrin e tyre është edhe ai i Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2010.

Sistemi Gjyqësor

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Njëra nga arsyet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion pikërisht rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferimeve politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i vitit të kaluar i EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovës ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe

në forma të llojlojta janë evidentuar.²⁷ Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm kishte regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.²⁸ Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova duhet të ndër marrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës - KGJK gjatë tre mujorit të parë nuk është treguar produktive në zgjidhjen e lëndëve anti-korrupsion. Bazuar në statistikat e saj shohim se në kuadër të kategorisë “shpërdorim me detyrën zyrtare ose autorizimit kanë qenë 81 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 17 lëndë të pranuar në punë, 98 lëndë aktualisht në punë, vetëm 14 lëndë të zgjidhura dhe gjithsej 84




26 Lëvizja FOL, monitorimi i Kuvendit të Kosovës, 22 Prill, 2011

27 Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9


28 Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2

lëndë kanë mbetur të pazgjidhura.


Në kuadër të kategorisë “marrja e ryshfetit” kemi 21 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 2 të pranuar në punë, 23 lënë aktualisht në punë, 0 lëndë të zgjidhura dhe 23 kanë mbetur të pazgjidhura.



Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi 9 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 0 lëndë të pranuar në punë, 9 lëndë aktualisht në punë, 0 lëndë të zgjidhura dhe 9 kanë mbetur të pazgjidhura.




Prokuroria e Kosovës ka shënuar progres të dukshëm gjatë kësaj periudhe kohore. Nga statistikat e saj për pesëmujorin 2011 shohim se në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë janë bartur gjithsej 89 lëndë nga vitet paraprake, ndërkaq 95 sosh janë pranuar në vitin 2011. Në Prokurorinë e Qarkut në Pejë janë bartur 5 lëndë nga vitet paraprake dhe 5 të tjera janë pranuar në vitin 2011. Në atë të Gjilanit janë bartur 4 lëndë nga vitet e mëparshme dhe 8 të tjera janë pranuar në vitin 2011; në atë të Prizrenit janë bartur 13 lëndë nga periudhat e mëhershme dhe 9 sosh janë pranuar në vitin 2011 dhe në atë të Mitrovicës janë bartur 13 lëndë dhe asnjë lëndë nuk është pranuar në vitin 2011.



Nga shqyrtimi i këtyre lëndëve dhe hetimeve të bëra kanë rezultuar gjithsej 4 aktakuza në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë; 8 në atë të Pejës, 1 në atë të Gjilanit, 1 në atë të Prizrenit dhe 1 tjetër në atë të Mitrovicës.

Aktakuzat e ngritura nga Prokuroritë e Qarkut Janar-Maj 2011




Nga shqyrtimi i këtyre lëndëve dhe hetimeve të zhvilluara kanë rezultuar 3 aktakuza dhe 19 propozim-aktakuza në Prokurorinë e Prishtinës; 2 aktakuza në atë të Pejës, 1 aktakuzë dhe 5 propozim-aktakuza në atë të Gjilanit; 2 aktakuza dhe 4 propozim-aktakuza në atë të Prizrenit; 7 aktakuza dhe 4 propozim-aktakuza në atë të Mitrovicës, 3 propozim-aktakuza në


Prokurorinë e Gjakovës dhe 1 aktakuzë e 5 propozim-aktakuza në atë të Ferizajt.

Ndërkaq në nivel komunal shohim se në prokurorinë e Prishtinës janë bartur gjithsej 112 lëndë nga vitet paraprake dhe 38 të tjera janë pranuar në vitin 2011; në atë të Pejës janë bartur 4 lëndë dhe janë pranuar 15 të tjera në vitin 2011; në atë të Gjilanit 4 lëndë janë bartur dhe 12 sosh janë pranuar në vitin 2011; në atë të Prizrenit 72 lëndë janë bartur nga vitet e mëparshme dhe 20 sosh janë pranuar në vitin 2011; në atë të Mitrovicës 40 lëndë janë bartur dhe 2 të tjera janë pranuar, në atë të Gjakovës 3 janë trashëguar dhe 4 të tjera janë pranuar dhe në atë të Ferizajt 4 janë bartur dhe 5 janë pranuar në vitin 2011.

Numri i aktakuzave/propozim-aktakuzave në Nivel Komunal - Janar - Maj 2011



Statistikat e Prokurorive në Nivel Komunal Janar-Maj 2011



Policia e Kosovës

Policia e Kosovës perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Raporti i EULEX-it ka treguar një shkallë progresioni të Policisë së Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar²⁹.


Gjatë këtij intervali kohor sipas statistikave të Policisë janë dërguar gjithsej 263 lëndë. Në kuadër të lëndëve të dërguara në prokurori me kryerës të njohur janë gjithsej 151 lëndë: 120 të dërguara në muajt janar-shkurt, 20 në muajt mars-prill dhe 11 sosh në muajin maj.

Në kuadër të lëndëve të dërguara me kryerës të panjohur janë vetëm 6 raste (në muajt janar-shkurt). Ndërkaq, në kuadër të rasteve të dërguara me raport të prokurorit janë gjithsej 106 raste: 72 raste të dërguara në muajt janar-shkurt, 26 raste në muajt mars-


prill dhe 8 raste të tjera në muajin maj.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se në muajt janar-maj janë zhvilluar gjithsej 245 hetime: 120 raste në muajt janar-shkurt, 108 raste në muajt mars-prill dhe 17 raste në muajin maj. Prej këtyre hetimeve kanë përfunduar 36 zyrtarë të arrestuar: 16 në muajt janar-shkurt, 36 zyrtarë të arrestuar: 16 në muajt janar-shkurt, 3 në muajt mars-prill dhe 17 në muajin maj.

**Statistikat e Policisë
Janar-Maj 2011**




**Statistikat e Policisë
Mars-Prill 2011**



²⁹ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23

Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përlllogaritet të jetë 4,807,984.00: 2,603,591.00 € në muajt janar-shkurt, 141,455.00 € në muajt mars-prill dhe 2,062,938.00 € në muajin maj.



Agjencia Kundër Korrupsion

Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë e përqendruar tek procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, tek publikimi i Raportit Vjetor 2010 dhe te miratimi i tij në Kuvendin e Kosovës. Më shumë se 95 % e zyrtarëve të lartë publikë e kanë deklaruar pasurinë e tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit. Sipas Ligjit mbi Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë³⁰ numri i zyrtarëve të lartë publik të cilët kanë pasur për obligim ta bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre tek Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë 1830. Nga ky numër i tërësishëm obligimin ligjor e kanë përmbushur 1746 ose 95.40%. Numri i atyre që nuk e kanë deklaruar pasurinë është 84 zyrtarë

apo 4.60%, ndërsa 26 zyrtarë të tjerë e kanë deklaruar pasurinë e tyre por që në fakt formulari nuk është i plotësuar konform ligjit dhe standardeve/kritereve të cilat i ka përcaktuar AKK-ja. Ndryshe, bazuar në nenin 16 të ligjit në fjalë AKK-ja është e obliguar që të iniciojë procedurë kundërvajtëse për të gjithë (84) zyrtarët të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë. Ndërsa sa i përket zyrtarëve të cilët nuk e kanë plotësuar formularin konform ligjit AKK do të kërkojë nga ta që ta bëjnë një gjë të tillë

brenda afatit 15 ditorë. Në të kundërtën është e obliguar që edhe ndaj tyre të iniciojë procedurë kundërvajtëse.³¹ Gjatw kwsaj kohe AKK-ja ka publikuar raport e saj vjetor 2010. Sipas kwrtij raporti rezulton se nga numri i përgjithshëm i lëndve të pranuar në Agjenci, hetuesit e Agjencisë kanë gjetur elemente bazike për te filluar hetimet në gjithsejt 139 raste. Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare ku të dyshuar kanë qenë gjyqtarw dhe staf tjetër i *Gjykatave të Republikës së Kosovës* janë evidentuar 17 raste. Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e *Institucioneve Tjera*, (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata

³⁰ Nr. 03/L-151, 11 shkurt, 2010, Dekreti nr. DL-008-2010, Datë 02.03.2010

³¹ Me hollësisht shih <http://www.akk-ks.org/?cid=1.4.287>


Elektroenergjetike e Kosovës, RTK, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish-Ndërmarrjet Shoqërore, Ndërmarrjet tjera Publike, Institucionet e Pavarura, OJQ-të, etj), si të dyshuar për veprime korruptive janë të evidentuar **47** raste. Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e zyrtarëve publik të **Qeverisë së Republikës së Kosovës** (ministritë si dhe agjencitë që veprojnë në kuadër të ministrive të caktuara) për periudhën raportuese, janë evidentuar **44** raste. **Pushteti Lokal** (Komunat e Republikës së Kosovës), përkatësisht personat zyrtar të nivelit lokal si të dyshuar për veprime korruptive, për periudhën raportuese janë evidentuar **28** raste. Në **Prokuroritë e Republikës së Kosovës** janë evidentuar 3 raste të dyshuara për veprime korruptive kundër prokurorëve të prokurorive publike.³²

Doganat e Kosovës


Doganat e Kosovës gjatë pesë muajve kanë shqiptuar gjithsej 19 masa disiplinore.

Në kuadër të tyre 3 kanë qenë në muajin janar, 8 në muajin shkurt, 5 në muajin prill dhe 3 të tjera në muajin maj.


Në kuadër të këtyre masave disiplinore 7 raste janë vërejtje me shkrim/gojë, 5 raste ndalim promovimi, 2 raste transfer në detyrë tjetër, 2 raste rekomandim për trajnim, 1 rast degradim nga pozita, 1 rast tjetër anulim performanse dhe 1 rast kompensim i pronës së dëmtuar të Doganave.



Ndërkaq në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale janë paraqitur gjithsej 17 raste: 4 raste në muajin janar, 5 raste në muajin shkurt, 4 raste në muajin mars, 4 raste në muajin prill dhe 1 rast tjetër në muajin maj. Muaji shkurt pra ka pasur më shumti raste, ndërkaq muaji maj më së paku - me vetëm 1 rast.




³² Agjencia Kundër Korrupsionit: Raporti Vjetor 2011, fq. 8



Në kuadër të Sektorit të Standardeve

Profesionale kemi 3 raste të shqiptuara për sjellje jo-profesionale gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, 1 rast për mos-deklarim të pasurisë, 4 raste për humbje/dëmtim të pronës së Doganës dhe 1 rast për mos-paraqitje në punë. Siç shihet edhe tabela



rastet më të mëdha janë paraqitur për neglizhencë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC - Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: www.monikorr.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e

qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontaktto:

Andrea Gropa 35, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Web: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org